

Disa të tjerë e falin namazin dhe lutjen e bëjnë ashtu siç duhet, pastaj presin të shohin ëndërr se si të veprojnë edhe kjo është gabim për shkak se Muhamedi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) kur na e mësoi se si të veprojmë gjatë istihares nuk ka përmendur se me anë të ëndërrës duhet të vendosim se çfarë të bëjmë.

Dobitë nga praktikimi i namazit të istihares

1. Personi që praktikon istiharen vërteton se zemra e tij është e lidhur me Allahun e Lartësuar për cdo vepër.
2. Është i kënaqur në caktimin e Allahut.
3. Istiharja është shkak që muslimani të gjejë lumturinë në këtë botë dhe në ahiret.
4. Besimtari që praktikon istiharen është i qetë për arsye se e jep mundin e tij në këtë botë duke e realizuar shkaqet që janë të nevojshme pastaj e kërkon zgjedhjen e më të mirës nga Allahu i Lartësuar.
5. Nevoja për të është e domosdoshme për çdo punë.
6. Me anë të namazit të istihares muslimanit i ngritet besimi se Allahu do ta ndihmojë atë në çdo punë dhe për çdo problem.
7. Me istihare muslimanit i shtohen shpërblimet për shkak se ai i drejtohet Allahut, falet, lutet dhe bën adhurime të ndryshme gjatë kryerjes së këtij adhurimi.
8. Me anë të istihares muslimani e madhëron Allahun, për arsye se i drejtohet Atij që t'i ndihmojë në zgjedhjen e çështjes më të mirë për të.
9. Me atë ai praktikon sunetin e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)


Përgatiti: Alaudin Abazi

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.



Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



Namazi i ISTIHAARES

mbyllet dera, për rrugën që do të ndjekësh e që do të jetë rruga jote në këtë botë e në botën tjetër. Oh! Ç'lumturi do të ketë në atë botë! Zemra gëzohet e lumturohet, kur kthehet te Zoti e penduar, duke ndjekur varganin e besimtarëve të mirë.

Vëlla musliman! Motër muslimane! Në qoftë se ke vendosur të pendohesh e të kthehesh tek Allahu, dije se pendimi ka disa kushte që duhen plotësuar patjetër. Kushtet janë:

- Të pendohesh dhe të të vijë keq për mëkatet e bëra.
- Të largohesh nga mëkati.
- Të vendosësh të mos kthehesh më tek mëkati e në qoftë se kthehesh, përsërite pendimin tek Allahu, por vendimi i dytë duhet të jetë i çiltër.
- Të pendohesh para frymës së fundit (para vdekjes) dhe para lindjes së diellit nga perëndimi (para Kiametit).

Përgatiti: Erion Sula

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
e-mail: penastudentore@hotmail.com



Një lajm i mirë për ty

Transmetohet nga Xhabir ibën Abdullah (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ua mësonte duanë e istihares për çdo çështje, sikurse ua mësonte suret e Kur'anit dhe thoshte:

"Kur dikush prej jush dëshiron të vendosë për një punë me rëndësi, le t'i falë dy rekate (nafile) namaz dhe pastaj le të thotë:

"All-llahume inni estehiruke bi 'ilmike ue estakdiruke bi kudretike ue es' eluke min fadlikel 'adhim, fe inneke takdiru ue la akdiru, ue ta'lemu ue la a'ëlemu ue ente al-lâmul gujûb. All-llahume in kunte ta'ëlemu enne hadhel emru (e emërton nevojën që ke) hajrun lî fi dinî ue me'âshî ue 'âkibeti emri ue 'âxhilihi ue 'âxhilihi fakdirhu lî ue jessirhu lî thumme barik lî fihî. Ue in kunte ta'ëlemu enne hadhel emru (e emërton nevojën e tij) sherrun lî fi dinî ue me'âshî ue 'âkibeti emri ue 'âxhilihi ue 'âxhilihi, fasrifhu annî uesrifnî anhu uakdir lî el-hajre hajthu kane thumme erdinî bihi."

"O Zot, me diturinë Tënde kërkoj të mirën! Kërkoj ndihmë prej fuqisë Sate, kërkoj prej të mirave të Tua të shumta, sepse Ti je i Gjithëfuqishëm e une jam i dobët, Ti di çdo gjë e unë nuk di, Ti je Ai që i di të fshehtat. O Zot, nëse kjo punë e imja (emërton këtu dëshirën, hallin, etj.) është mirësi për fenë dhe jetën time, për kohën e tashme dhe të ardhmen, bëj të mundshme që të realizohet, lehtëso dhe beko! E nëse kjo punë është e dëmshme për fenë dhe jetën time, për të tashmen të ardhmen dhe për në ahiret, largoje prej meje dhe më largo mua nga ajo, më përcakto hajrin kudo qoftë, pastaj më bëj të kënaqur me të!" (Transmeton Buhariu)

Komenti i hadithit

Njeriu në këtë botë ballafaqohet me sprovime dhe probleme të ndryshme, shpeshherë mbetet edhe në udhëkryq kur duhet të vendosë për diçka, nuk di çfarë të zgjedhë, prandaj ka nevojë t'i drejtohet Zotit të tij dhe çështjen e tij ia lenë Atij që është më i Dijshmi për të gjitha gjërat.

Namazi i istihares është një nga adhurimet më të rëndësishme për muslimanin kur përballet me hutinë në zgjedhjen e çështjes që është më e drejtë për te dhe nuk di çfarë të zgjedhë.

Ç'është istiharja?

Istiharja është të kërkohet më të mirën nga dy apo më shumë zgjedhje.

P.sh: dëshiron të udhëtosh diku, dëshiron të martohesh, dëshiron të blesh një veturë, etj., para se ta bësh këtë hap i fal dy rekate dhe pastaj e bën lutjen që thuhet pas këtij namazi, siç e përmendëm në hadithin e mësipërm. E nëse të lehtësohet ajo punë, dije se kjo është mirë për ty, e nëse të vështirësohet dije se ka qenë keq dhe mosrealizimi i kësaj vepre është më mirë për ty.

Si falet namazi i istihares?

Namazi i istihares falet dy rekate, sikurse çdo namaz tjetër nafile në çfarëdo kohe, gjatë ditës apo natës. Nuk ka të caktuar se çfarë të këndohet, kështu që mund të këndojmë pas sures Fatihë çdo sure apo pjesë nga Kur'ani. Pas namazit i ngre duart dhe lavdëron Allahun, dërgon salavate mbi Pejgamberin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) pastaj thua duanë e istihares, të cilën e kemi përmendur më lartë.

Vlera e këtij namazi

Po të mos kishte ndonjë të mirë tjetër përveç se ai që e praktikon këtë, do t'i mjaftonte, duke pasuar kështu Pejgamberin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

Imam Neveviu thotë: "Pas istihares duhet ta bëjmë atë çështje për të cilën na hapet zemra dhe nuk bazohemi në atë që kemi pasë dëshirë para se të falnim namazin. Prandaj kërkohet nga ne që ta ndërpresim zgjedhjen dhe të mos mendojmë për të derisa ta falim namazin e nëse nuk e bëjmë kështu, atëherë nuk numërohet se ne i jemi drejtuar Allahut me sinqeritet që të na zgjedhë çështjen që është më e mirë për ne".

Domosdoshmëria e të përmbajturit me atë që na është transmetuar rreth istihares

Duhet të kemi kujdes nga ajo që e bëjnë disa nga njerëzit injorantë apo edhe nga ata që dijnë, por nuk e kanë kuptuar urtësinë e istihares, kështu që përdorin disa lutje të posaçme për istihare e jo atë lutje që na ka mësuar Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!).

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) pa një nënë e cila po kërkonte fëmijën e saj në moçal; kur e gjeti, nëna e shtrëngoi fëmijën në gji dhe i dha të pijë. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) tha:

"A mund ta hedhë kjo nënë fëmijën e saj në zjarrë?" "Jo" thanë shokët e Pejgamberit (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) Atëherë, Pejgamberi (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) ua ktheu:

"Allahu është më i Mëshirshëm me robtë e Tij se sa kjo nënë me fëmijën e saj."

Allahu Ekber! Allahu është më i Madh! E, pra, a mund të mos e kërkojmë pendesën pas kësaj mirësie? Pas kësaj bujarie a mund të vonohemi në pendesë?! O Zot! I Lartësuar je Ti! Sa i Mëshirshëm je! Sa i Butë e Bujar je!

Çfarë të ndalon ty të pendohesh e të ndjekësh rrugën e drejtë? Mbase thua familja, shoqëria, shokët! Kam frikë mos pendohem e më pas i kthehem përsëri mëkatit! Mëkatet e mia janë të shumta; e, si mund të më falen!

A mendon se ti do t'i thuash këto te Zoti yt Ditën kur ta takosh atë? Jo për Zotin! Familja, shoqëria, shokët janë pengesa të imagjinuara, që i shkatërron vetëm ai që i frikësohet Allahut.

O besimtar e besimtare! Jini krenar për fenë tuaj! Jini çiltërisht të vendosur për të mirën dhe ngulmoni në të, duke u mbështetur Allahut të Madhëruar. Pastaj, kujtoni mëshirën e Zotit tuaj dhe pafundësinë e Faljes së Tij.

Vëlla! Motër! Sikur të të vijë ty në këtë çast meleku i vdekjes, a je i kënaqur ta takosh Zotin tënd pa u penduar?

Vëlla! Motër! Mos i dredho vetes dhe gjykimin të saj, sepse, në qoftë se nuk i kërkon llogari sot, nesër vendosesh në varr e atëherë s'të bën dobi pendimi.

I dashur vëlla! E dashura motër! Vendos tani, para se të

Allahu i Madhëruar thotë:

"O robtë e Mi, që e keni ngarkuar veten tuaj me shumë mëkate, mos e humbisni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, sepse vërtet, Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai fal shumë, Ai është Mëshirëplotë!" (Kurani-39:53).

Allahu i shndërron të gjitha të këqijat në të mira. Për këtë Ai thotë:

"Vetëm në qoftë se pendohen e bëjnë vepra të mira, atëherë, Allahu ua shndërron të këqijat në të mira." (Kurani-25:68-70).

Ç'mirësi dhe fitim i madh! O Zot i madh! Këtë mirësi e fitim mund ta lërë pas dore vetëm një i paditur e mospërfillës. Prandaj pendohu i dashur vëlla dhe e dashur motër, nëse dëshiron këtë fitim të madh. Dëgjo çfarë ka thënë Pejgamberi (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) për të na nxitur në pendim:

"Allahu është më i Gëzuar për pendimin e robit të vet..." (E transmetojnë Buhariu dhe Muslimi).

Pejgamberi (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të!) thotë, gjithashtu:

"Allahu i Madhëruar thotë: "Orobi im! Sa kohë të më lutesh Mua e të shpresosh tek Unë, Unë i fal të gjitha mëkatet e tua. Orobi im! Sikur të arrinin mëkatet e tua deri në kupë të qiellit e pastaj të më kërkoje të falur, do të të falja!" dhe Allahu i Madhëruar thotë:

"O robtë e mi! Ju bëni mëkate natën dhe ditën dhe Unë jua fal të gjitha mëkatet, prandaj më kërkon falje Mua, që t'ju fal ju."

Dhe:

"Padyshim, Allahu e shtrin Dorën e Tij natën që të pendohet mëkatari i ditës dhe e shtrin Dorën e Tij ditën që të pendohet mëkatari i natës, derisa dielli të lindë nga perëndimi (deri në Ditën e Kiametit)."